



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

SHPALLJE E REKRUTIMIT

Komuna e Kaçanikut, në mbështetje të nenit 17 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, sipas vendimit të KPMK-ës të dt. 20.11.2013, më dt. 02.12.2013 rishpallë konkursin për plotësimin e vendit të lirë të punës:

TITULLI I VENDIT TË PUNËS:

I. Drejtor i Qendrës për Edukim dhe Arsim Parashkollor "AGIMI" në Kaçanik

Drejtoria: Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës

Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës: (Koeficienti 7.8)

Numri i referencës së vendit të punës: 16-18150/13

Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Përgjegjësi ekzekutive në menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit
2. Harton planprogramin e punës
3. Është përgjegjës për krijimin e kushteve ditore për fëmijët e të gjitha grupeve
4. Përcjellë punën e edukatorëve në realizimin e plan-programit të punës
5. I raporton organeve kompetente komunale për aktivitetet në kuadër të planprogramit
6. Është përgjegjës edhe për çështje tjera të rregulluara sipas legjislacionit në fuqi.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

- Në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative dhe të cilat kanë aftësi fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse.

Procedurat e konkurrimit: Procedura e konkurrimit është e hapur për të gjithë kandidatët e jashtëm si dhe nëpunësit civil ekzistues.

Shkollimi i kërkuar, Aftësitë, përvoja dhe attribute tjera që kërkohen:

- Të kenë të kryer njërin nga Fakultetet përkatëse të licencuara të Universitetit të Prishtinës dhe të Fakulteteve private të akredituara dhe të licencuara nga MASHT-i.
- Të kenë më së paku tri vjet përvojë pune në arsim
- Të kenë aftësi menaxheriale për përmbushjen e detyrave të punës
- Të posedojnë licencën si mësimdhënës të kualifikuar
- Të kenë të përfunduar me sukses një program kualifikimi profesional për udhëheqje, administrim ose fushë të ngjashme i cili është i autorizuar nga MASHT-i, sipas rekomandimeve të KSHLM-ës.
- Njohuri të mira në aplikimin e programeve Microsoft office (Excel, Word, Power point)

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Përzgjedhja bëhet duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kohëzgjatja e emërimit : Sipas legjislacionit në fuqi.

Data e mbylljes së konkursit; Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik.

Paraqitja e kërkesave: Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në shërbimin e shkrimore - **Zyra e pranimit**, kati përdhës dhe në web-faqen komunale .

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente: Diplomën e Fakultetit të kryer apo Kopjen e vërtetuar të Diplomës, Dëshmi për përvojën e punës, kopjen e letërnjoftimit, certifikatën e lindjes, certifikata mbi trajnimet e kryera, CV-në sipas modelit të MASHT-it, Programin zhvillimor të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese (më së shumti 5 faqe tekst me 30 rreshta të letërës të formatit A-4), Certifikatën shëndetësore me të cilën dëshmohet gjendja shëndetësore, Rekomandimin nga një person apo institucion publik-kredibil.

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë"

"Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës"

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen. Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë zyrën e personelit

**Kryetari i Komunës
z.Besim Ilazi**